

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Mediat serbe nisin 'festën' pas vendimit për ish-krerët e UÇK-së: Fajtorët u dënuan!
ADRESA	https://joq-albania.com/artikull/1392026.html
BURIMI	joq-albania.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 11:16:07 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	16 shtator 2026, 11:01:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 16 shtator 2026, 11:00:00 UTC → 16 shtator 2026, 11:02:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	87b3cc0082ffd8e7abcfca333e94ca130ef0194fe1bd2a17b23c57448c583c1d1
TEKSTI	f2a6478a7c4da4ca03901d7f19948f0f03e105397566f2c4d086467e24819e7e
PAMJA	ebc7cc6722c0b0901e15f272a8ed5cb92e68ac780333a717dc6d863d6e8468bd

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	d9df596871fb70e04cfa08e0686c3d17e2db8c213cb21d96c49220739489b9ea
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	06975047e5a3601e37e96e97bfab995ceed02fbc2c1535a000f7cb9180af2b1a
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/d9df596871fb70e04cfa08e0686c3d17e2db8c213cb21d96c49220739489b9ea>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Mediat serbe nisin 'festën' pas vendimit për ish-krerët e UÇK-së: Fajtorët u dënuan!

Shkruar nga: A Shehaj | Publikuar më: 16.09.2026, 13:01

f Share

t Share



Mediat serbe i kanë kushtuar vëmendje të gjerë aktgjykimit ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit në Hagë.

Në titujt e tyre bie në sy përdorimi i një gjuhe të fortë dhe, në disa raste, cilësime të drejtpërdrejta për UÇK-në dhe ish-krerët e saj. Aktgjykimi i sotëm i shkallës së parë i dënoi të katër për krime lufte, ndërsa akuzat për krime kundër njerëzimit nuk u provuan sipas standardit të kërkuar nga gjykata.

B92 e hap raportimin me titullin:

"Reshje aktgjykimesh: Thaçi – fajtor; Veseli – fajtor; Krasniqi – fajtor; Selimi – fajtor; udhëheqësve të UÇK-së 25 vjet burg."

Media thekson se Hashim Thaçi është dënuar me 25 vjet burgim, ndërsa Kadri Veseli me 18 vjet, Jakup Krasniqi me 25 vjet dhe Rexhep Selimi me 13 vjet.

Kurir përdor një titull dukshëm më të ashpër:

"Aktgjykimi ndaj udhëheqësve të UÇK-së kriminale, të katër fajtorë për krime lufte: Hashim Thaçit dhe Jakup Krasniqit nga 25 vjet burg! Veselit 18, Selimit 13!"

Në tekst, Kurir përsërit se të katër janë shpallur fajtorë për krime lufte dhe jep dënimet përkatëse: Thaçi 25 vjet, Krasniqi 25, Veseli 18 dhe Selimi 13 vjet burgim. Media serbe veçon gjithashtu pretendimin e aktakuzës se krimet kanë prekur rreth 407 të ndaluar, prej të cilëve të paktën 102 janë vrarë.


Blic e vendos në qendër të titullit dënimet:

"Hashim Thaçi dhe Krasniqi dënohen me 25 vjet burg, Veseli me 18! Haga shpalli aktgjykimet ndaj udhëheqësve të UÇK-së."

Në raportim thuhet se Thaçi, Krasniqi, Veseli dhe Selimi janë dënuar në Hagë, duke veçuar veçanërisht dënimin 25-vjeçar të Thaçit. Blic përmend gjithashtu atmosferën rreth gjykatës në Hagë: përkrahësit e të akuzuarve kishin qëndruar gjatë natës pranë gjykatës me flamuj dhe pankarta të UÇK-së, ndërsa policia kishte shtuar masat e sigurisë. Media i referohet gjithashtu interesimit të madh të gazetarëve për procesin. blic.rs

Hashim Thaçi dhe tre ish-drejtesit e tjerë të UÇK-së janë gjykuar në Hagë për akuza që përfshijnë përndjekje, torturë, vrasje dhe zhdukje të detyruara gjatë dhe pas luftës në Kosovë. Çështja është veçanërisht e ndjeshme për shqiptarët e Kosovës, shumë prej të cilëve e konsiderojnë Thaçin dhe UÇK-në si simbole të rëndësishme të luftës për pavarësinë e Kosovës.

FACT CHECK: Synimi i JOQ Albania është t'i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e [raportoni këtu](#).



Më të Lexuarat



ARTIKULL JOETIK?

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR

TË NGJASHME

Më të fundit



Dërgo materialin tënd këtu >

Puno me ne!

Marketing

Politika e privatësisë

Rreth Nesh

Kushtet e përdorimit

Kontakt

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.